



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

**FTESË PËR APLIKIM PËR ANËTARË TË KOMISIONIT
VLERËSUES PËR PROJEKTET NGA FUSHAT:**

***ART VIZUAL-FIGURATIV, BOTIME, FESTIVALE, KINEMATOGRAFI, MUZIKË,
ORGANIZIME, SHOQËRI KULTURORE-ARTISTIKE, TEATËR, TRASHËGIMI
KULTURORE, MANIFESTIME, MBËSHJETJE TË AKTIVITETEVE VJETORE TË
ORGANIZATAVE DHE OPERATOREVE KULTURORË***

Në bazë të rregullores **MF-NR-04/2017** për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të si dhe rregulloren për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës, bazuar në thirrjen publike për fushat e ndara në dy kategori si:

- 1- Festival, Organizime, Kinematografi, Manifestime, Muzikë, Teatër;**
- 2- Art Vizuel-figurativ, Botime, Mbështetje e aktiviteteve vjetore të organizatave dhe operatorëve kulturorë, Shoqëri Kulturo- Artistike, Trashëgimi kulturorë.**

Ftojme të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të cilët nuk janë nën hetime apo me precedent penal, dhe që kanë përvojë në shoqërinë civile, të aplikojnë për pjesëmarrje në Komisionin Vlerësues në cilësinë:

- Një përfaqësues nga OJQ-të, (për kategorinë 1 dhe 2);
- Një ekspertit i fushës, (për kategorinë 1 dhe 2).

Përfaqësuesi/ja e lartcekur që përzgjidhet, do të jetë anëtar/e e komisionit vlerësues me të drejtë vote për vlerësimin e projekt-propozimeve komfor procedurave të rregullta administrative.

Aplikuesit duhet të jenë persona me përvojë profesionale me mbi 3 vite në të paktën njërin nga fushat e lartpërmendura.

Të gjithë të interesuarit në këtë procese aplikimi, duhet të dërgojnë CV e tyre në postën elektronike zyrtare: kultura.pr@rks-gov.net.

Aplikim fillon me datë: **14.02.2019** dhe do të zgjasë deri më **21.02.2019**.

Për më shumë informata, mund të kontaktoni në numrin e tel. **038 226 417**;

038 230 900 -lok: 1141.